



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE

Nr. 428/3 Prot.

Tiranë, më 13.04.2017

VENDIM

Nr. 61, datë 13/4 /2017

Në mbështetje të nenit 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, pikës 3 dhe 5 të nenit 24, të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e Informimit”, shkronjës a) të nenit 31/1 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar, ligjin nr.10279, datë 20.05.2010 “Për kundërvajtjet administrative”, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale,

V Ë R E N:

Ankuesi, Znj. _____, ka depozituar pranë Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim quajtur “Komisioneri”) Formularin e Ankesës nr. 428 Prot., datë 07.03.2017, me objekt “*Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare*”, kundër Autoritetit Publik “Ministria e Energjisë dhe Industrisë” (në vijim quajtur “Autoriteti Publik”).

Ankuesi, në cilësinë e përfaqësuesit të Shoqërisë “IT-AL SERVIS” shpk, nëpërmjet shkresës së datës 25.10.2016 dërguar me postë me datë 14.02.2017, ka paraqitur pranë Autoritetit Publik, kërkesën për informacion si më poshtë:

1. *Një kopje të akteve që ndodhen në dosjen e miratimit të Lejes Koncesionare të lëshuar në favor të Hec “Denas Power”.*

Me pretendimin se është cënuar në të drejtën për informim, pasi nuk është informuar lidhur me sa ka kërkuar, ankuesi i ka kërkuar Komisionerit ushtrimin e kompetencave që i njeh ligji për rastet e refuzimit të dhënies së informacionit nga Autoriteti Publik.

Në ndjekje të procedurës për shqyrtimin administrativ të çështjes, Komisioneri, me urdhrin nr. 107 Prot, datë 05.04.2017, ka urdhëruar kryerjen e inspektimit administrativ pranë Autoritetit Publik.

Gjatë inspektimit u konstatua se kërkesa e Znj. _____ është depozituar pranë Autoritetit Publik dhe është regjistruar me nr. 1063 Prot., datë 16.02.2017.

Koordinatorja për të Drejtën e Informimit pranë Autoritetit Publik sqaroi grupin e inspektimit se kërkesa e Znj. _____ i ka kaluar për trajtim Drejtorisë së Koncesioneve, Prokurimeve, Shpronësimeve dhe Privatizimit.

Koordinatorja pohon se është vënë në dijeni për rastin pas njofimit nga Zyra e Komisionerit për përmbushje të detyrimit për dhënie informacioni dhe ka vepruar duke e deleguar kërkesën në drejtoritë përkatëse (konkretisht Drejtoria e Koncesioneve, Prokurimeve, Shpronësimeve dhe Privatizimit dhe Drejtoria e Politikave dhe Zhvillimit Elektroenergjetik.) duke i rikujtuar për afatin ligjor. Nga verifikimi në zyrën e protokollit, Koordinatorja sqaron se dy drejtoritë kanë proceduar për rastin nëpërmjet *Memo*-ve të brendshme, duke mos e vënë në dijeni dhe duke mos i dhënë akses në dosjen që përfshin të gjithë praktikën e Znj.

Grupi i inspektimit, konstatoi se Autoriteti Publik nuk i ka kthyer përgjigje kërkesës për informim brenda afatit të parashikuar në ligj.

Në bazë të nenit 15 të Ligjit Për të Drejtën e Informimit, Autoriteti Publik trajton kërkesën për informim brenda 10 ditëve punë nga data e dorëzimit të saj. Në çdo rast, mostrajtimi i kërkesës brenda këtij afati konsiderohet refuzim dhe bazuar në nenin 18, pika 2 a) e Ligjit nr. 119/2014 “Për të Drejtën e Informimit” (në vijim quajtur “Ligji Për të Drejtën e Informimit”) përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë e cila varion nga 150 000 deri në 300 000 lekë.

Në përfundim të inspektimit u parashtruan faktet dhe u hartua procesverbali, i cili u nënshkrua nga ana e Koordinatorit për të Drejtën e Informimit pranë Autoritetit Publik.

Në bazë të pikës 2, të nenit 2, të Ligjit për të Drejtën e Informimit, *“informacion publik” konsiderohet çdo e dhënë e regjistruar në çfarëdo lloj forme dhe formati, gjatë ushtrimit të funksionit publik pavarësisht nëse është përpiluar ose jo nga Autoriteti Publik”.*

Bazuar në pikën 3 të nenit 3 të ligjit sipërcituar, *“Çdo person ka të drejtë të njihet me informacionin publik, nëpërmjet dokumentit origjinal ose duke marrë një kopje të tij në formën ose formatin që mundëson akses të plotë në përmbajtjen e dokumentacionit”.*

Për sa më lart personat përgjegjës duhet të procedojnë me dhënien e informacionit/dokumentacionit dhe në rast se informacioni i kërkuar është subjekt i kufizimeve të përcaktuara në pikën 1 të nenit 17 të Ligjit për të Drejtën e Informimit, ta vënë atë në dispozicion të kërkuarit në përputhje me pikën 6 të nenit 17 të këtij ligji, i cili përcakton se: *“Nëse kufizimi prek vetëm një pjesë të informacionit të kërkuar, pjesa tjetër nuk i refuzohet kërkuarit. Autoriteti Publik tregon qartë pjesët e dokumentacionit përkatës që janë refuzuar, si dhe në bazë të cilës pikë të këtij neni është bërë ky refuzim”.*

Pas shqyrtimit të ankesës, konstatimeve të grupit të inspektimit dhe shqyrtimit të provave të administruara, Komisioneri vlerëson se shkelja e konstatuar përbën kundërvajtje administrative dhe si e tillë sanksionohet me gjobë sipas nenit 18, pika 2 a) e tij.

Në lidhje me ankimin e Znj. kundër Autoritetit Publik, Komisioneri vlerëson se ankimi është i drejtë dhe duhet pranuar.

PËR KËTO ARSYE

Bazuar në shkronjën a) të pikës 2 dhe pikën 3 të nenit 18, pikën 3 të nenit 19, pikat 1 dhe 2 të nenit 21, nenin 22, shkronjën b) të pikës 5 të nenit 24 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, ligjin nr.10279, datë 20.05.2010 “Për kundërvajtjet administrative”, shkronjën a) të pikës 1 të nenit 18 të ligjit nr 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar,

V E N D O S A:

1. Pranimin e ankesës së Znj. _____, nr. 428 datë 07.03.2017 ndaj autoritetit publik “Ministria e Energjisë dhe Industrisë”, me objekt “Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare”.
2. Urdhërimin e Autoritetit Publik “Ministria e Energjisë dhe Industrisë”, për vënien në dispozicion të dokumentacionit të kërkuar (sipas kërkesës për informacion datë 25.10.2016 regjistruar në regjistrin e protokollit të institucionit me nr. 1063 Prot., datë 16.02.2017).
3. Dënimin e Koordinatorit për të Drejtën e Informimit pranë Autoritetit Publik “Ministria e Energjisë dhe Industrisë”, Znj. _____ me gjobë në vlerën 150.000 (një qind e pesëdhjetë mijë) lekë në përputhje me nenin 19, pika 3. Masa e dënimit me gjobë, shlyhet me këste mujore. Gjoha ekzekutohet nga zyra e financës së Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë brenda 6 muajve nga data e njoftimit të vendimit.
4. Kundër vendimmarrjes në pikat, 1 dhe 2, palët kanë të drejtën e ankimit brenda 45 ditëve në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë në përputhje me nenin 25 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”.
5. Kundër vendimmarrjes në pikën 3, personi ndaj të cilit është vendosur sanksioni administrativ ka të drejtën e ankimit brenda 30 ditëve në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, në përputhje me nenin 22 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”.
6. Ky vendim u dha sot në datë 13. 4 .2017.

Besnik DERVISHI

KOMISIONERI

